

# Njoftim mbi vendimet e Këshillit të Lartë të Prokurorisë në Seancën Plenare të datës 21 Maj 2019

POSTED 22/05/2019 KLP

Komisioni i Karrierës në Këshillin e Lartë të Prokurorisë paraqiti në mbledhjen plenare e radhës propozimin e saj për caktim të përkohshëm në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokaster. Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenet 164/8, 166/2, 189/1/a të Ligjit 115 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë, si dhe në Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të Prokurorëve”, relatori i Komisioni i Karrierës në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, z. Sandër Beci propozoi emrin e prokurorit Julian Cafka për caktim të përkohshëm në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokaster. Shkat i këtij emërimi është bërë shkarkimi nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit të prokurorit Arben Pashko pas seancës dëgjimore e zhvilluar në datën 16 Maj 2019. Arben Pasho ka pasur një karrierë të gjatë në sistemin e drejtësisë dhe prej vitin 2011 ai mbante postin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër. Propozimi i Komisionit të Karrierës është miratuar me 11 vota pro.

Me 11 vota pro u miratua projekt-aktit për shtyrjen e fatit të caktimit të përkohshëm të prokurorit z. Altin Dumani, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, në funksionin e drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda. Z. Altin Dumani do të ushtrojë funksionin e Drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda, përkohësisht nga data 22.05.2019 – 22.08.2019.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë vendosi me 11 vota pro për shtyrjen e fatit të caktimit të përkohshëm të prokurores znj. Rozeta Qirjaqi, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Korçë, të caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e Drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Korçë. Znj. Rozeta Qirjaqi, do të ushtrojë funksionin e Drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Korçë, përkohësisht nga data 22.05.2019-22.08.2019.

Gjithashtu, me 11 vota pro është miratuar shtyrjen e fatit të caktimit të përkohshëm të prokurores znj. Irena Çunoti prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, të caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Korçë. Znj. Irena Çunoti, do të ushtrojë funksionin e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Korçë, përkohësisht nga data 22.05.2019 – 22.08.2019.

Çeshtja e fundit në rendin e ditës ishte miratimi i projekt-vendimit për caktim në detyrë të prokurorës Denisa Asko. Relatori i Komisioni i Karrierës në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, z. Sandër Beci propozoi caktim në detyrë të prokurorës Denisa Asko në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Znj. Hasko ka qënë e komanduar në Ministrinë e Drejtësisë deri në datën 15 Maj 2019 dhe me mbarimin e periudhës e komandimit, kërkon rikthimin në sistemin e prokurorisë. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë votuan me 6 vota pro dhe 5 vota kundër ( Gent Ibrahim, Alfred Balla, Tartar Bazaj, Kostaq Beluri, Sandër Beci ) propozimin për caktimin në detyrë të prokurorës Denisa Asko në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

